



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

K.DH.SH.II.nr.97/24

GJYKATA KOMERCIALE – Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Ramush Bardiqi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Rahovica Commerce” ShPK., me seli në rrugën Ahmet Kaçaniku p.nr. në Ferizaj, kundër debitorit “Toifor” ShPK me seli në lagjen Emshir në Prishtinë, për shkak të borxhit sipas dokumentit të besueshëm – faturës, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës , Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.402/23, të datën 30.11.2023, me datën 11.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit “Rahovica Commerce” ShPK., me seli në rrugën Ahmet Kaçaniku p.nr. në Ferizaj, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.402/23, të datën 30.11.2023, VËRTETOHET.

II. Mbetet e pashqyrtuar pika II (dy) e dispozitivit të aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.402/23, të datën 30.11.2023.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.402/23, të datën 30.11.2023, në piken I të dispozitivit e ka pranuar si bazuar prapësimi i debitorit “Toifor” ShPK., me seli Prishtinë dhe shfuqizohet urdhri përmbarimor P.nr.378/2021 i datës 06.12.2021 i përmbaruesit privat Mubarak Shumolli me seli në Ferizaj. Ndërsa në piken II të dispozitivit ka vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale lidhur me procedurën në këtë gjykatë, sipas prapësimit të debitorit.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë ka parashtruar përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar të gjendjes faktik dhe naplikimit të së drejtës materiale, me propozimin që gjykata ta aprovoje ankesën në tërësi si të bazuar dhe ta ndryshoje aktvendimin e shkallës së parë, ashtu që ta refuzojë prapësimin e debitorit më tërësi si të pabazuar dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Debitori në përgjigjen në ankesë, i ka propozuar gjykatës që ankesa e kreditorit të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktvendimin KPPP.nr.402/2023 të datës 30.11.2023 ta vërtetoje.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Kreditori “Rahovica Commerce” ShPK, me seli në Ferizaj, më 06.12.2021 ka parashtruar propozim për përmbaremore në zyrën e përmbaremit privat Mubarak Shumolli me seli në Ferizaj, me të cilin ka kërkuar që të detyrohet debitori “Toifor” ShPK që t’ia paguaj shumën prej 30,066.53€ me kamatë ligjore prej 8% deri në pagesën definitive dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore. Propozimin për përmbaremore e kishte bazuar në faturën nr. 13/2021 të datës 12.08.2021 të lëshuar nga ai për Debitorin, të cilën në kopje me ngjyrë ia bashkëngjitur Propozimit. Përmbaremi më 06.12.2021 e ka nxjerrë urdhrin përmbaremit P.nr.378/2021 me të cilin e ka lejuar në tërësi përmbaremit sipas Propozimit.

Debitorit më 15.01.2023 ka parashtruar prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin dhe i ka kërkuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin dhe ta anuloj Urdhrin. Ai ka pretenduar se fatura lëndore është e mangët dhe nuk përbënë bazë për caktimin e përmbaremit, për shkak se nuk e përmban kohën e përmbaremit së detyrimit monetar, duke shtuar se borxhi nuk është arritur për pagesë. Prapësimi nuk ia ka bashkëngjitur asnjë prove, ndërsa e ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale për paraqitjen e prapësimi.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilin ka kërkuar që Prapësimi të refuzohet si i pabazuar dhe Urdhri të vërtetohet. Ai ka deklaruar se Prapësimi është i pabazuar, pasi nuk ekziston asnjëra nga shkaqet për ushtrimin e Prapësimi, si dhe Debitori nuk e ka bashkëngjitur asnjë provë për pretendimet e tij. Përgjigjes në prapësim nuk ia ka bashkëngjitur asnjë prove, ndërsa e ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale lidhur me paraqitjen e përgjigjes në prapësim në shumë prej 208€.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin KPPP.nr.402/23, të datën 30.11.2023, me datën 06.03.2024, e ka pranuar si bazuar prapësimi i debitorit “Toifor” ShPK., me seli Prishtinë dhe shfuqizohet urdhri përmbaremit P.nr.378/2021 i datës 06.12.2021 i përmbaremit privat Mubarak Shumolli me seli në Ferizaj, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Ne arsyetim të aktvendimit ka theksuar se pas shqyrtimit të pretendimeve të Debitorit të paraqitura në Prapësim dhe deklarimeve të Kreditorit në përgjigje ndaj prapësimi, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, ka gjetur se prapësimi është i bazuar. Nga shkresat e lëndës rezulton se Kreditori i ka lëshuar Debitori faturën lëndore. Gjithashtu, nga shkresat e lëndës rezulton se Kreditori i ka bashkëngjitur Propozimit në kopje me ngjyra të pa vërtetuar faturën lëndore, ndërsa në shkresa

të lëndës nuk ka prova nga të cilat rrjedhë se Përmbaruesi e ka ftuar Kreditorin që të bëjë ndonjë përmirësim në Propozim ose të dorëzoj ndonjë provë ose shkresë. Prandaj, mbi këtë bazë ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi të atakuar.

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parapara me nenin 182 par.2 të LPK-së, për arsye se i njëjti është i kuptueshëm, i qartë dhe përmban arsye bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, e të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Sa i përket pretendimeve për zbatimin e gabuar të dispozitave të procedurës përbarimore dhe për shkak të vërtetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka pranuar prapësimin e debitorit dhe e ka anuluar urdhrin përbarimor P.nr.378/2021 i datës 06.12.2021. Gjykata e shkallës së parë, me vendosjen si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, ka konstatuar drejtë faktin se dokumenti i besueshëm-fatura , në bazë të cilit organi përmbarues ka caktuar përbarimin, nuk i plotëson tiparet e përmbarueshëmërisë.

Me Nenin 37 të Ligjit për Procedurën Përbarimore (LPP) është paraparë se “*Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*”. Ndërsa me nenin 38 para. 1 i LPP-së përcaktohet se “*Propozimi për përbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përbarimi*”, ndërsa nenit 40 para. 1 nënpara. 3 i LPP-së është paraparë se “*Propozimi për përbarim në bazë të dokumentit të besueshëm duhet të përmbajë origjinalin apo kopjen e vërtetuar të dokumentit të besueshëm*”. Prandaj, në rastin konkret rezulton se për ta caktuar përbarimin, kreditori në momentin e dorëzimit të propozimit për përbarim duhet ta dorëzoj origjinalin ose kopjen e vërtetuar të dokumentit të besueshëm, në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se fatura me Nr. 13/2021 të datës 12.08.2021 nuk është në origjinal , dhe po ashtu kopja nuk është e vërtetuar ashtu sic kërkohet sipas LPP-së.

Kjo Gjykatë vlerëson se Gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur kur është mbështetur edhe në dispozitën e nenit 38 para. 2 i LPP-së, i cili shprehimisht ka urdhëruar se “*Në rast se propozimi për përbarim nga paragrafi 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore*”. Prandaj , në rastet kur propozimi nuk paraqitet sipas para. 1 të nenit 38 të LPP-së, i cili siç u cek më lartë kërkon se që së bashku me propozimin për përbarim të paraqitet dokumenti përbarimor ose dokumenti i besueshëm në origjinal ose në kopje, atëherë përmbaruesi privat e ka për obligim që ta zbatoj nenin 102 të LPK-së, sipas të cilit propozimi duhet të kthehet në korigjim. Andaj, në rastin konkret, Përmbaruesi nuk e ka ftuar Kreditorin që ta dorëzoj dokumentin besueshëm në origjinal ose kopje të vërtetuar te noteri. Si pasoj e kësaj, rasti nuk është paraqitur ligjërisht para

Përmbauesit, rrjedhimisht nuk ishin plotësuar kushtet për nxjerrjen e Urdhrit. Prandaj, në këtë rast gjen zbatim neni 43 para. 3 i LPP-së, sipas të cilit “Përmbauesit privat nxjerrin urdhrin për përmbaueshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përmbushin kushtet për përmbaueshmëri, Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbaueshmëri nga përmbauesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”.

Bazuar në dispozitat e lartcekura, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, kur ka pranuar prapësimin me arsyet se urdhri për përmbaueshmëri është lejuar mbi bazën e faturës të cilat jo vetëm se nuk janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, por fatura nuk përmban as elementet për t’u cilësuar si faturë e rregullt apo dokument i besueshëm ngase faturës me Nr. 13/2021 të datës 12.08.2021 nuk është në origjinal, dhe po ashtu kopja nuk është e vërtetuar ashtu siç kërkohet sipas LPP-së.

Së këndejmi, Gjykata gjen se urdhri për përmbaueshmëri i caktuar nga përmbauesi privat është lëshuar në bazë të një propozimi për përmbaueshmëri i cili nuk i ka plotësuar kushtet që kërkohen me Nenin 38 të LPP-së.

Dhoma e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, i vlerësoi të gjitha pretendimet ankimore të kreditorit por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala kreditore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala debitorë ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e mos kryerjes së përmbaueshmërit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt pranë gjykatës kompetente.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pabazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështrojnë sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbaueshmëri. Andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar prapësimin e debitorit dhe e ka shfuqizuar urdhrin për caktimin e përmbaueshmërit të Përmbauesit Privat, P.nr.378/2021 të datës 06.12.2021.

Gjykata ka vendosur sikurse në pikën II (dy) të këtij aktvendimi, pasi që pika II (dy) e aktvendimit të ankimuar, nuk kanë qenë objekt ankimit.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së dytë
K.DH.SH.II.nr.97/24, me datë 11.03.2024

**Gjyqtari,
Ramush Bardiqi**